



Gefällt mir

Follow @KultPlus

740 followers

K

Ballina

Teatri

Filmi

Arti Pamor

Libri

Muzika

Trashëgimia



Feride Berisha: Të botuarit e një libri, është të lexuarit ndryshe



Feride Berisha

Është femra e vetme botuese në Kosovë dhe nëpërmjet Shtëpisë Botuese PA ka sjell 18 tituj, të cilët e përbëjnë kryesisht autorë të rinj por me emër të qëndrueshëm në letërsi. Ardian Kyqyky, Beqë Cufaj, Gëzim Aliu, Blerina Rogova Gaxha janë vetëm disa nga emrat që kanë botuar librat në këtë shtëpi botuese që shpesh i bën prezantime edhe në Gjermani. Në një intervistë për KultPlus, Berisha ka thënë se pos që i ka botuar veprat e këtyre autorëve ajo ka bërë përpjekje edhe përkthimin e tyre në gjuhën gjermane, por, që deri më tash janë interesuar

vetëm për një nga botimet e PA. Duke treguar për sfidat, kënaqësinë dhe dashurinë për librin në mes të tjerash ka thënë edhe atë se : Nuk janë librat ata që e ndryshojnë jetën, por po mos të kishte libra jeta do të ishte ndryshe. E këtë jetë kurrsesi nuk do të doja ta jetoja

Ardianë Pajaziti


KultPlus: Jeni femra e vetme botuese në Kosovë, ndalemi në këtë segment, si të shohin botuesit meshkuj në Kosovë?

Feride Berisha: Reagimet nga ana e kolegëve në Kosovë kanë qenë nga më të ndryshmet, por në përgjithësi kam raporte të mira me ata që i njoh. Disa nuk i njoh personalisht, vetëm si emër. Edhe shpresoj se nuk do të mbes hasret, njoh gra tjera që janë shumë të afta dhe uroj të marrin guximin dhe të botojnë edhe ato vetë. Shembull i mirë na vjen nga Shqipëria, ku më të zonjat janë botueset se sa botuesit. Mendim i imi personal.

KultPlus: Çfarë shtrirje ka shtëpia botuese PA?

Feride Berisha: Aktivitetet e mia si botuese, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri janë më shumë nëpërmes produktit- Librit, apo gjatë panairove të librit. Kam përvoja shumë të mira, por nganjëherë ma merr mendja se disa tituj më shumë kanë gjetur shtëpinë në Shqipëri, se sa në Kosovë. Bashkëpunoj me një shtëpi botuese nga Tirana “Pika pa Sipërfaqe” dhe me libraritë e atjeshme.

Organizojë lexime në Prishtinë, Berlin, ndërsa shpërndarja e librave të PA bëhet si nëpër libraritë e Kosovës, ashtu edhe në Shqipëri. Disa tituj i kemi edhe në Shkup dhe Tetovë. Duke ecur me kohën e bëjmë shitjen edhe nëpërmes internetit, nëpërmes portalit internacional – Amazonit .



KultPlus: Për aq sa kemi vërejtur ju keni botuar librat e autorëve që

vlerësohen të jenë gjeneratë e re, si erdhi deri te kjo përzgjedhje, se shtëpia botuese PA ka këtë kriter, apo se veprat që botuat ju rrëmbyen?

Feride Berisha: Rruga prej botueses deri te dorëshkrimi, apo deri te autori janë shtegtime të ndryshme. Nganjëherë vinë autore(ë)t tek botuesja, nganjëherë anasjelltas. Kjo është sa ju përket botime të autore(ë)ve tanë, ndërsa kur janë në pyetje veprat nga autorët gjermanë që dëshiroj t'i përkthej në shqip, atëherë kriteri i vetëm është që mua të më pëlqejnë. Më interesojnë temat që pak a shumë janë tabu në Kosovë, apo në përgjithësi në letërsinë shqipe.

Gjithashtu jam tejet e lumtur që deri më tani kam botuar katër tituj të autorëve nga Shqipëria, që për mua është një vlerësim pozitiv i punës serioze të PA.

KultPlus: Sa botime keni realizuar deri më tashti dhe cilin do ta konsideroni më të suksesshin?

Feride Berisha: Në listën e botimeve të PA kemi arritur shifrën tetëmbëdhjetë, për çka jam shumë krenare. Unë nuk mund t'i ndaj titujt që i kam botuar vetë, por mund të them se me më shumë energji dhe përkushtim jam ndaj titujve që i përkthej vetë. Puna si përkthyesë kërkon më shumë mishërim, ndërsa puna si botuese më duket se është më shumë teknike. Natyrisht se pa e punuar me shpirt, as ajo teknikja nuk bëhet mirë, sepse librat e PA janë ende punë dore. Asgjë nuk shkon në shtyp, pa e tjerr disa herë mirë. Pra faktori kohë nga marrja e dorëshkrimit, e deri te nisja për shtyp nuk duhet të neglizhohet aspak. Po, një autor do ta veçoja, me shpresë se nuk do tu mbetet hatri të tjerëve; ky është Jamarbër Marko me vëllimin e poezive të tija “Rastësisht me dashje” dhe “Pro Nobis”. Nëse dikush deri më tani nuk e njeh, e ende nuk e ka zbuluar këtë autor, atëherë i lus që të fillojnë e ta lexojnë. Ka libra që lexohen dhe futen prapë në dollap, palosen dhe rrinë urtë. Mirëpo poezia e Jamarbër Markos nuk është e tillë, ajo nuk të lë të qetë.



KultPlus: Keni tentuar që librat që i keni botuar ti përktheni edhe në ndonjë gjuhë të huaj?

Feride Berisha: Për tre tituj jam përpjekur që të gjejë botues gjermanë, por për fat të keq deri më tani kam arritur vetëm për një titull të zgjoj interesim, dhe bisedat janë në zhvillim e sipër. Kjo është punë e agentëve letrar, të cilët në hapësirën shqiptare mungojnë edhe gjithashtu nuk guxojmë të harrojmë kërkon shumë kohë.

KultPlus: Tash për tash, keni në dorë ndonjë dorëshkrim që pritet të botohet?

Feride Berisha: Po, tani është në përgatitje finale një vëllim me poezi nga poeti Shqiptar Oseku dhe një roman i një autorit gjerman, Max Frisch, të cilin jam duke e përkthyer në shqip dhe që do të del nga shtypi me titullin " Unë, vetja ime dhe dikush tjetër" për panairin e librit në Tiranë.

KultPlus: Mësuam se do ta bëni një prezantim në Gjermani, me shkrimtarin shqiptar, Ardian Kyçyku, më konkretisht për çfarë bëhet fjalë?

Feride Berisha: Fjala është për një mbrëmje leximi nga romani "Home" të autorit të mirënjohur shqiptar Ardian-Christian Kyçyku në hapësirat e LiteraturHausBerlin, një ndër adresat më të mira për të lexuar. Kyçyku jeton në Bukuresht, dhe do të vij nergut për këtë lexim në Berlin. Kjo mbrëmje pjesërisht do të përkrahet nga

Ambasada e Republikës së Kosovës në Gjermani dhe për këtë jam më se mirënjohëse. Romani ka për temë migrimin, kështu që përshtatet shumë mirë që edhe të lexohet në diasporë. Edhe ky roman, është i tillë, që lexues-es/it i mbetet në kokë, dhe sa herë që të lexohet të shton edhe më shumë kureshtje. Nëse e kam kuptuar mirë, ose ashtu siç unë e kam kuptuar, romani na jep një mesazh që njeriu tërë jetën migron në vetvete. Si duket na mbushet mendja se stacioni i parë dhe i fundit është vetvetja. Jam shumë kureshtarë dhe e lumtur që është bërë e mundshme që të lexohet dhe të bashkëbisedohet për një libër shumë të mirë me qytetarët shqiptar në Berlin.

KultPlus: Pas këtij prezantimi, keni në listë edhe autorë të tjerë që do të prezantoni jashtë vendit?

Feride Berisha: Kisha pasur shumë dëshirë që të prezantoj edhe Gëzim Aliun, se është njëri ndër autorët e parë të PA dhe Manjola Brahaj, se shkruan shumë bukur edhe në gegnishte.

Blerina Rogova-Gaxha dhe disa autorë tjerë kanë lexuar në Gjermani nëpërmes programeve tjera të ftuar drejtpërdrejt, e me dy autor kemi lexuar në vjeshtën e kaluar. Pra parakushti i vetëm nuk është dëshira ime, por mundësitë materiale.



KultPlus: Dhe për fund, prej se keni themeluar shtëpinë botuese PA e deri më tashti, si vlerësoni a është gjetje e duhur që plotëson shpirtin

tuaj?

Feride Berisha: Të botuarit e një libri, është të lexuarit ndryshe. Dorëshkrimi lexohet, studiohet, lexohet edhe një herë, se mos ka shpëtuar diçka. Por nuk është për fat të keq vetëm kaq. Nëse guxoj të them troç: më shumë e ndjejë veten si përkthyes, se sa botuese. Por puna si botuese megjithatë e ka atë peshën e vet: të zgjedhësh vetë titullin, kopertinën, të përcjellësh një vepër deri sa ta sheh dritën është një punë tepër e rëndësishme dhe e bukur. Përkushtimi si botues dhe angazhimi, për fat të keq kushtojnë vetëm kohë dhe nuk paguhen. Problemet që jo vetëm unë kam, por edhe botuesit e tjerë janë si pikë e parë: më shumë kemi shkruar, se lexues; shpërndarja edhe nëse bëhet mirë, nuk ke mundësi të kontrollosh. Nuk shpaguhet kurrsesi kjo punë kaq e vlefshme dhe e rëndësishme. Është pak a shumë punë angarie, edhe pse është një mision. E vetmja mbështetje deri më tani është nga ana e Ministrisë së Kulturës, që disa tituj i kanë blerë, e disa tituj i kanë përkrahur. Edhe nga një fondacion kemi pasur përkrahje, por vetëm për përkthim. Mirëpo për punën si botues nuk ka asnjë kompensim: është qesharake që të besohet, se nga librat e shitura mund të fitohet gjë. Zakonisht libri sa i përket vlerës reale, asnjëherë nuk e shpagan veten. Nëse do të punohej, ashtu siç ishte dashur, që nga honorari i autorit, redaktimi, lektorimi, faqosja, e deri te shtypi atëherë bëhet fjalë për një shumë jo reale në kornizat e mundësive tona. Pra më shumë është idealizëm, sesa rezon. Pra mungojnë lexuesit, që do ta kishin ndihmuar që kjo punë të jetë më kualitative dhe më plotësuese edhe për ata që e bëjnë: botueset dhe botuesit.

Natyra e punës si botuese ka nganjëherë faza dëshpëruese, sepse më shumë shpenzohet koha për çështje teknike duke shtruar kërkesa dhe kërkuar sponzorë, sesa duke u marrë me punën kryesore at të përcjelljes sa më dinjitoze të dorëshkrimit deri te libri. Mos të harrojmë edhe përkujdesja për autorët është pjesë shumë e rëndësishme e kësaj pune.

Mirëpo një moment shumë i lumtur, që të bënë të harrosh vështirësitë e punës, janë librat kur posa dalin nga shtypi janë të ngrohta, si fëmijët e porsalindur. Pra je dëshmitare dhe shkaktare e një lindjeje. Dhe për këtë edhe ja vlen. Nuk janë librat ata që e ndryshojnë jetën, por po mos të kishte libra jeta do të ishte ndryshe. E këtë jetë kurrsesi nuk do të doja ta jetoja./**KultPlus.com**

Like

24

Tweet

0



Add a comment...

Comment

Facebook social plugin